



## Lajmet e Fundit:

Qarku Korçë – U konstatuan duke transportuar 17 emigrantë të paligjshëm, shpallet në kërkim 1 shtetas, procedohet penalisht 1 tjetër



18/07/2021

## Tiranë – Policia identifikon, kap dhe arreston 17-vjeçarit që reklamonte në rrjetet sociale foto me armë zjarri

Tiranë

Policia identifikon, kap dhe arreston 17-vjeçarit që reklamonte në rrjetet sociale foto me armë zjarri.

Gjendet dhe sekuestrohet arma e zjarrit automatike si dhe një armë e ftohtë (thikë).

Specialistët për Hetimin e Krimit në Komisarariatit e Policisë Nr.6, në vijim të punës për rritjen e parametrave të sigurisë, kapjen e personave në kërkim apo personave që qarkullojnë me armë zjarri apo i mbajnë ato në banesë, falë bashkëpunimit me qytetarët dhe pas një pune hetimore kanë bërë të mundur identifikimin e 17 -vjeçarit, i cili reklamonte në rrjetet sociale armë zjarri dhe qëllonte në ajer.

Në përfundim të veprimeve të para hetimore është bërë arrestimi në flagrancë i 17-vjeçarit K. S, banues në Kombinat, Tiranë.

Shërbimet e Policisë gjatë kontrollit fizik të ushtruar ndaj 17-vjeçarit i kanë gjetur me vete një armë të ftohtë (thikë) dhe gjatë kontrollit në vendin ku kishte reklamuar fotot, është gjetur edhe arma e zjarrit e llojit kallashnikov.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprat penale të "Armëmbajtja pa leje" dhe "Mbajtja pa leje e armëve të ftohta".

Share

Share

Share

Share

Email

[◀ Respekto rregullat e qarkullimit rrugor, shpëto jetë!](#)
[DVP Berat – Evidentohen dhe goditen dy raste të tentativës për kultivim të bimëve narkotike ▶](#)

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)